



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 281, Datë 06.11.2025

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 176, DATË 29.08.2024
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ACHELO” SH.P.K., NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
“KOTORRI” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1.9 MW”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar;; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.11.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 2790 prot., datë 05.11.2025, “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 176, datë 29.08.2024 “Mbi licencimin e shoqërisë “ACHELO” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kotorri” me kapacitet të instaluar 1.9 MW”,

Konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “ACHELO” sh.p.k.

- Shoqëria “ACHELO” sh.p.k. me vendimin nr. 176, datë 29.08.2024, është licensuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kotorri” me kapacitet të instaluar 1.9 MW, për një afat 30-vjeçar.
- Në kuptim të sa përcaktuar në pikat 2 dhe 3 të vendimit shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kotorri”, jo më vonë se data 04.08.2025 dhe duhet të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujqor brenda datës 16.11.2027.

2. Korrespondenca dhe Dokumentacioni i Depozituar nga Shoqëria

- Shoqëria “ACHELO” sh.p.k. ka depozituar në ERE raportimet periodike për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Kotorri”, për periudhën maj – shtator 2025.
- Nga shqyrtimi i këtyre raportimeve, evidentohet se shoqëria ka hyrë në prodhim nga data 21 maj 2025.

3. Analiza Ligjore dhe Vlerësimi

- Për sa përcaktuar në pikën 2 të vendimit nr. 176/2024 rezulton se shoqëria ka filluar ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kotorri”, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të vendimit të sipërcituar.
- Për pasojë, pika 2 e dispozitivit të vendimit të bordit të ERE-s nr. 176/2024, vlerësohet të shfuqizohet.
- Gjithashtu, në përmbajtjen e pikës 4 të të njëjtit vendim është konstatuar një gabim material në referencën e brendshme ku në vend që t’i referohej pikës 3 (të cilës i përket afati për depozitimin e lejes së rinovuar të përdorimit të burimit ujqor), gabimisht i është referuar pikës 2.
- Për pasojë, pika 4 e dispozitivit të vendimit të bordit të ERE-s nr. 176/2024, vlerësohet të ndryshohet referimi nga pika 2 në pikën 3.

4. Nevoja për Ndryshimin e Vendimit

- Në mbështetje të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë, vlerësohet se pikat 2 e dispozitivit të vendimit të bordit të ERE-s nr. 176, datë 29.08.2024, duhet të shfuqizohet, pasi shoqëria “ACHELO” sh.p.k. ka përmbushur kushtin përkatës dhe duhet të reflektohet situata aktuale e realizimit të projektit.
- Gjithashtu, pika 4 e vendimit nr. 176/2024 përcakton se: *Në rast se shoqëria nuk depoziton lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujqor brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 dhe ka një vendim për ndërprerjen/pezullimin e veprimtarisë nga inspektoratet/agjencitë e mbrojtjes së territorit/mjedisit, atëherë ajo nuk ka të drejtë të operojë/ushtrojë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.*
- Në kuadër të korrigjimit të gabimit material të konstatuar, duhet të bëhet: *Në rast se shoqëria nuk depoziton lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujqor brenda afatit të përcaktuar në pikën 3 dhe ka një vendim për ndërprerjen/pezullimin e veprimtarisë nga inspektoratet/agjencitë e mbrojtjes së territorit/mjedisit, atëherë ajo nuk ka të drejtë të operojë/ushtrojë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 2 e vendimit të ERE-s nr. 176, datë 29.08.2024, shfuqizohet.
2. Pika 4 e vendimit të ERE-s nr. 176, datë 29.08.2024, ndryshohet si vijon: *“Në rast se shoqëria nuk depoziton lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujqor brenda afatit të përcaktuar në pikën 3 dhe ka një vendim për ndërprerjen/pezullimin e veprimtarisë nga inspektoratet/agjencitë e mbrojtjes së territorit/mjedisit, atëherë ajo nuk ka të drejtë të operojë/ushtrojë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”.*
3. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, të njoftojë shoqërinë “ACHELO” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OSSH” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a., lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI